



1

Republika e Kosovës
Republika Kosovo / Republic of Kosovo
Kuvendi i Komunës Rahovec
Opština/Skupština Rahovac/Municipality of Rahovec



PROCESVERBALI

Mbledhja e Komitetit për Komunitete të Kuvendit Komunal të Rahovecit, e mbajtur me datë: **17.06.2020** me fillim në ora **10.15**. Këtë mbledhje e kryesoi kryesuesi i Komitetit për Komunitete z. Bajram Morina.
Kryesuesi – Fillimisht më lejoni të ju përshëndes të gjithëve për praninë tuaj në këtë mbledhje të Komitetit për Komunitete, përshëndes anëtarët e Komitetit për Komunitete. Ky është takimi i dytë për vitin 2020, për takimin e sotëm i kemi këto pika të rendit të ditës:

REND DITE

- 1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar;**
- 2. Informatë rreth dëmtimit të varrezave të komunitetit Romë, ashkali, egjiptian;**
- 3. Informatë rreth gjendjes socio ekonomike të komunitetit jo shumicë gjatë kohë së Pandemisë me Virusin Covid - 19;**
- 4. Të ndryshme.**

Kryesuesi – Pasi që është takimi i parë për vitin 2020, ju uroj të gjithëve punë të mbarë dhe sa më shumë suksese. E qes në votim rendin e ditës: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar rendi i ditës. Kalojmë në pikën e parë të rendit të ditës.

1. Aprovimi i procesverbali nga mbledhja e kaluar.

A ka dikush të shtoj diçka sa i përket procesverbalit, E qes në votim pikën e parë: Konstatohet se në mënyrë unanime është aprovuar pika e parë e rendit të ditës. Kalojmë në pikën e radhës:

2. Informatë rreth dëmtimit të varrezave të komunitetit Romë, ashkali, egjiptian.

Për këtë fjalën ja japë shefit të zyrës për Kthim dhe Komunitete z. Lendrit Qeli.

Lendrit Qeli – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, me datë 10 prill kemi marrë në informatën se janë dëmtuar rreth 19 varreza, ku nga ta 18 i prekësin komunitetit romë. Ashkali dhe egjiptian dhe një komunitetit shqiptar. Ne këto varreza i kemi vizituar edhe me kryetarin e komunës dhe anëtarët e kuvendit të Republikës së Kosovës që vinë nga radhët e komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian, ku i kemi parë për së afërmi dëmtimin e varrezave, deri më tani ende nuk ka ndonjë informatë sa i përket se kush e ka bërë këtë vepër penale, presim që këtë ta zgjidhin organet e rendit. Kjo lënë të kuptohet se dikush me qëllim e ka bërë këtë vepër me qëllim që të prishë këtë marrëdhënie të mirë ndëretnike që e kemi ne në komunën e Rahovecit. Ne si zyre menjëherë kemi kërkuar sanimin e varrezave, në bazë të raportit të komisionit të cilin e ka caktuar kryetari për të i vlerësuar dëmet, ku dëmi i përgjithshëm sipas këtij komisioni është 3,040.00 €, kjo është një shumë simbolike e dimë që ka mundur të kushtojë një gurë i varrit sa komplet kjo kosto, por këto janë mundësit tona. Ne kemi kërkuar fonde shtesë nga donatorët e ndryshëm sepse ne si zyre nuk kemi fonde, kemi hasur në mirëkuptim me Ministrin për Komunitete dhe Kthim dhe komunën e Rahovecit,

nga informata që e kam nga kryetari i komunës, në momentin që do fillojnë të rinovohen varrezat e dëshmorëve, do të bëhet edhe rinovimi i këtyre 19 varrezave të dëmtuara.

Mirjeta Krasniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne si anëtar të kuvendit nuk i pranojmë këto akte vandale që i bëhen varrezave qofshin ato të komunitetit pakicë apo shumicë, po ashtu kërkoj nga organet e ligjit që të dënohen keqbërësit dhe të vetëdijesohet komuniteti që këto nuk i shërbejnë askujt. Jemi kundra prishjes së marrëdhënieve të mira që e kemi multi etnike, prandaj shpresoj se këta keqbërës të dënohen sa më parë nga organet e drejtësisë.

Ramë Berisha – Përshëndetje për të gjithë pjesëmarrësit, kur bëhet fjalë për dëmtimin e varrezave të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian, besoj se ajo dukuri nuk është bërë vetë nga natyra, por nga dora e njeriut dhe me motive të caktuara. Problemet që ndodhin brenda familjes apo brenda fqinjëve nuk duhet të ndikojë në atë që të prishen varrezat apo ndonjë monument fetar ose kulturo historike sepse kjo shkon në dëm të vetë shoqërisë që jeton në atë komunë, këta që e bëjnë këtë janë njerëz shumë të ulët dhe duhet të dënohen nga organet e rendit.

Ali Zhuniqi – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, ne këtë akte të ulët absolutisht që e dënojmë, shpresojmë se në të ardhmen nuk do të ndodhin më këso akte, shpresojmë se personat të cilat e kanë kryer këtë akt të vendosen para drejtësisë dhe të marrin dënimin e merituar.

Kryesuesi – Ju faleminderit për diskutimin dhe mbështetjen e dhënë, kalojmë në pikën e radhës.

3. Informatë rreth gjendjes socio ekonomike të komunitetit jo shumicë gjatë kohë së

Pandemisë me Virusin Covid – 19.

Edhe për këtë pikë fjalën ja japë shefit të zyrës për kthim dhe komunitete z. Lendrit Qeli.

Lendrit Qeli – Duke e ditë që pandemi nuk një asnjë nacionalitet, por duke e ditur që komuniteti jo shumicë sidomos ato të marginalizuara në Kosovë e posaçërisht në komunën tonë ndikon shumë më shumë duke e ditur se ata ballafaqohen edhe me probleme socio ekonomike. Ne si zyre jemi munduar që të gjejmë modalitetet të ndryshme që ti mbështesim ata, ne si zyre kemi fatin që të kemi bashkëpunëtor të ndryshëm dhe ne kemi komunikuar vazhdimisht me ta, ku kemi gjetur një mbështetje nga ana e tyre, ku i kemi ndihmuar pastaj familjet e komuniteteve në komunën e Rahovecit. Mbështetja e parë në fillim të pandemisë ka qenë nga komuna e Rahovecit ku kanë ardhur në depot e komunës ndihma të shumta nga humanistë të ndryshëm, ku i kemi ndihmuar rreth 100 familje të komunitetit serb, si në lagjen e epërme ashtu edhe në fshatin Hoçë e Madhe, pastaj janë ndihmuar edhe 100 familje të komunitetit romë, ashkali dhe egjiptian, duke përfshi pjesën e epërme dhe disa fshatra. Ndihma e dytë ka ardhur nga organizata AQH në bashkëpunim me zyrën zvicerane në Kosovë, kjo ndihmë ka qenë e dedikuar vetëm për komunitetin romë, ashkali dhe egjiptian, ku janë ndihmuar rreth 170 familje me gjëra ushqimore dhe higjienike. Ne si zyre kemi insistuar që ndihmat të jenë edhe për komunitetin serb, por politikat e donatorëve kanë qenë asisoj ku dëshira e tyre ka qenë vetëm për këto 3 komunitete dhe ne prezencën e tyre. Pastaj në bashkëpunim me UNMIK-un kemi gjetur modalitetet tjera që ti mbështesim pjesën e epërme me ndihma, posaçërisht komunitetin serb sepse edhe ashtu ka qenë e dedikuar për ta. Kurse faza e tretë e mbështetjes që ka qenë para tre jave ka qenë nga organizata Nevo Koncepti, kjo është një organizatë romë nga Prizreni, ku me ndihmat e tyre janë ndihmuar rreth 140 familje, ne kemi kërkuar që të ndihmohen 170 familje, pra të gjithë jo vetëm ata që jetojnë në gjendje skamnore, por edhe ata që kanë humbur vendin e punës dhe këto muaj i kanë pasur të rëndë, por politikat e donatorit në minutat e fundit kanë ndryshuar. Mjetet e tjera janë destinuar edhe në arsim për fëmijë të komuniteteve të cilët nuk kanë pasur mundësi të qasen online në mësim gjatë kohë së pandemisë, gjithashtu ky donator ja ka mbuluar edhe pagesat për internet. Misioni kryesor i kësaj organizate në fakt është arsimimi i këtyre tre komuniteteve, prandaj ky ndryshim ka pasur përputhshmëri 100% me punën e kësaj organizate. Një ndihmë tjetër na ka ardhur nga shoqata fetare Islame Rahmeti ku janë ndihmuar rreth 160 familje të komunitete romë, ashkali dhe egjiptian, por bashkëpunimi nuk ka qenë 100% me zyre, ne si zyre vetëm ju kemi dërguar listën se kujt duhet të i shpërndahen ndihmat, kurse ata e kanë bërë shpërndarjen pa ne. Ajo që është e rëndësishme për ne si zyre është se kryesisht komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian kanë përfituar deri në katër herë ndihma, besoj se kjo nuk do të jetë ndihma e fundit, do të ketë edhe ndihma tjera në të ardhmen, kjo është një sukses për ne sepse nëse i krahasojmë komunat që i kemi për rreth, tek ata ndihma ka qenë shumë më e vogël, p.sh në Gjakovë komunitetit pakicë shumë më pak është ndihmuar nëse e krahasojmë me Rahovecit, prandaj në emër të

zyrës dhe komunës së Rahovecit i falënderojmë të gjitha ata që na kanë ndihmuar. Ne si zyre jemi të shqetësuar shumë se si Ministria për Komunitete dhe Kthim nuk bërë asgjë për komunitetin pakicë në komunën tonë, sidomos për periudhën e pandemisë, pa hyrë në aspektin politik, por ne si zyre kemi kërkuar që së paku të i ndihmohet më shumë komunitetit serb, pasi që komuniteti romë, ashkali dhe egjiptian kanë mare më shumë ndihma nga donatorët, pasi edhe ata e udhëheqin këtë ministri, kemi marrë premtime që do të na ndihmojnë, por ndihmat nuk kanë ndodhur asnjëherë të paktën nuk kemi asnjë informacion zyrtar që janë shpërndarë këto ndihma edhe pse kemi një informacion jo zyrtar se janë shpërndarë deri në 25 pako me ndihma ushqimore për komunitetin serb, kjo ka ndodhur në koordinim me dike nga fshati Hoçë e Madhe. Shpresoj se në të ardhmen do të kemi bashkëpunim më të madhe me ministrin dhe nuk do të kemi më këso probleme.

Ramë Berisha – Kur kemi të bëjë me ndihmat e ndarë për qytetarët në nevojë pas përhapjes së kësaj pandemie, neve na kanë ardhur ndihmat si ushqimore ashtu edhe higjienike, për këtë falënderoj kryetarin e komunës sepse me këtë të gjithë ata qytetarë që kanë pasur nevojë ju është lehtësuar pak gjendja financiare, por ashtu falënderoj edhe donatorët e ndryshëm së bashku me shefin zyrës për kthim dhe komunitete z. Lendrit Qeli. Falënderoj po ashtu edhe bashkatdhetarët tanë të cilët kanë ndihmuar në të hodha familjarët të cilët janë në gjendje sociale si komunitetin pakicë ashtu edhe atë shumicë.

Mirjeta Krasniqi – Së pari falënderoj të gjithë humanistët dhe kuvendin komunal për ndihmat që i kanë ndarë komunitetit, po ashtu falënderoj edhe z. Lendrit Qeli i cili e përfaqëson në mënyrë shumë të lartë zyrën për kthim dhe komunitete të komunës sonë. Po ashtu kërkoj që të përfshihen të gjitha familjet të komunitetit pakicë dhe jo vetëm familjet që janë në nevojë, kishte me qenë mirë që të kontaktohen të gjitha familjet dhe të shikohet nëse kanë nevojë për ndonjë ndihmë këta familjar. Po ashtu dua ta di nëse kanë nevojë dikush nga nxënësit e këtyre komuniteteve për ndonjë pajisje elektronike për ndjekjen e mësimi online.

Lendrit Qeli – Sa i përket çështjes së arsimit ne jemi në fazën e vlerësimit që të dimë saktë se sa fëmijë nuk anë pasur pajisje elektronike për ndjekjen e mësimi online, organizata që e potencova më parë Nevo - Koncepti është njëri nga donatorët që dëshiron të ndihmojë në këtë proces, në kuadër të implementimit të një projekti të financuar nga fondacioni KFOS. Kam pasur komunikim të vazhdueshëm edhe me Ministrin e Arsimit, ku kemi pasur takim edhe me ministrin për këtë çështje, por kjo nuk është vetëm shqetësimi i ynë por edhe i komunave tjera, ka pasur një donacion rreth shpërndarjes së këtyre pajisjeve por nuk e di se si ka shkuar faza e shpërndarjes.

Kryesuesi – Po ashtu edhe unë falënderoj kryetarin dhe ekipin e tij për mbështetje që na ka dhënë gjatë kësaj kohe të pandemisë me pako ushqimore dhe higjienike, po ashtu falënderoj edhe donatorët e ndryshëm të cilët na kanë ndihmuar në këtë kohë pandemie.

Të nderuar sa i përket çështjes së arsimit pasi edhe unë punoj në shkollën e fshatit Ratkoc si tutor, sa i përket pajisjeve teknologjike mundem të them se shumica e nxënësve nuk kanë qasje në mësimin online ose në distancë, ne kemi bërë kërkesa në drejtorin e arsimit dhe në disa organizata por deri më tani nuk kemi asnjë përgjigje. Nëse nuk ka askush të shtoj diçka rreth kësaj pika, kalojmë në pikën e radhës:

4. Të ndryshme.

Ka dikush të shtoj diçka tek pika të ndryshme.

Darko Antiq – Përshëndetje për të gjithë të pranishmit, desha të ju informoj se para dy dite është bërë djegia e një shtëpie në lagjen e epërme të një serbi, kjo nuk është hera e parë që bëhet kallja e shtëpive, deri më tani ende nuk kemi ndonjë informatë se kush e ka bërë këtë. Kërkoj që në mbledhjen e KKS-së të diskutohet rreth kësaj pike dhe organet kompetente të mërin me seriozitet këtë çështje dhe të vihen para drejtësisë keqbërësit sepse për komunitetin tonë siguria është në rend të parë.

Lendrit Qeli – Ne jemi të informuar rreth ndezjes së shtëpisë së Nikolla Simiq i cili është larguar nga Kosovës në vitin 1999 – 2000, në bazë të informatave që i kemi menjëherë kemi shkuar në vendin e ngjarjes, ku kemi parë që policia dhe zjarrfikësit ishin duke bërë ekspertizën. Ne nuk mundemi të japim konkluzë në këtë drejtim janë organet e rendit për këtë, por sipas disa informatave jo formale dhe jo zyrtare që na kanë ardhur, ajo pronë është në shitje dhe për me i ra vlera kësaj prone besohet se një herë është ndezur shtëpia qëllimisht, por këto janë informata jo zyrtare. Por siç e thash dikush është duke u munduar ta prishë marrëdhënien e mirë që e kemi ndër etnike në komunën e Rahovecit.


Kryesuesi – Pajtohem plotësisht me atë që e tha z. Lendir Qeli, kjo punë është në dorën e organeve të policisë dhe shpresoj se ky rast dhe rastet e tjera shumë shpejtë të zbardhen.

Mbledhja përfundoi në orën: 11: 15

Procesmbajtësi


Agim Hoti

Kryesuesi i Mbledhjes


Bajram Morina

